Mehmet Bislimi

Libra të botura deri më tani:

„Anekdota popullore dhe satira autoriale", Prishtinë 2002.

„Trëndafila maji" poezi, Prishtinë, 2002.

„Fjalë dhe gurë" poezi, Prishtinë 2003.

„Këtu i thonë Drenicë" Tahir Meha - monografi, Prishtinë 2004.

„Ironi e verdhë poezi, Prishtinë 2005.

"Stinë e vonuar" poezi, Prishtinë 2008.

„Shkrime publicistike", Prishtinë 2009.

„Anekdota popullore dhe satira autoriale II" Prishtinë 2010.

„Mehmet Della alias Mehmeti i Vogël" Prishtinë 2011.

Mehmet Bislimi - SHPIRTNDRITURI

Mehmet Bislimi

SHPIRTNDRITURI

Poezi

Mehmet Bislimi
SHPIRTNDRITURI

Mehmet Bislimi
SHPIRTNDRITURI

Redaktor:
Zenun GJOCAJ

Lektor:
Emin HALIMI

Recensent:
Adnan ASLLANI

Ballina dhe faqosja
Sabir KRASNIQI

Botues:
PPG "Shkrola"
Prishtinë

Copyright & 2012
Autori

Mehmet Bislimi

SHPIRTNDRITURI

P O E Z I

... Ata ranë ditën me diell, me besimin tek Zoti dhe Liria, nga jeta e rëndë nuk u ankuan kurrë.
Ata e çmonin jetën më shumë nga ne, mbi të gjitha e çmonin lirinë, së cilës ia falën edhe jetën Ata ikën, mbase me të vetmen brengë se nuk do të jenë gjallë, kur atdheu do të jetë më i mirë, më i bukur, më i çliruar dhe përfundimisht i bashkuar-kjo ishte aspirata e tyre që nuk u përmbush. Deri në përmbarimin e saj, ata prehen të qetë, por prehja nuk i qetëson!...

... kënga ime, këngë e vjetër
veç teje, këtë natë nuk gjeta
jo
nuk gjeta
prehje tjetër

- autori

FJALA E REDAKTORIT

DREJT SHTEGTIMEVE TË REJA E MË TË THELLA POETIKE

Nga shkaku i veprimtarisë atdhetare, përndjekjes dhe vuajtjes së dënimit nga pushtuesi sllav, sa i përket veprimtarisë letrare, M. Bislimi, megjithatë, e arriti hapin e kohës. Në mënyrë intensive me veprimtari artistike ai u mor që në vitet tetëdhjeta, sidomos kur u deshtë të mërgohet në Zvicër, nga shkaku i përndjekjeve të pushtuesit, ku jeton edhe sot e kësaj dite. Shkrimet e para të tij botohen së pari në "Bota e re" më 1986. Ndërkaq, me botime veprash, filloi që në fillim të këtij shekulli, pikërisht më 2002, ku pothuaj për çdo vit botoi nga një vepër të zhanrit të ndryshëm, sidomos poezisë.

Veprat e tij poetike shprehin veçoritë e botës së modeluar poetike, përdegëzimet metonimike të shprehjes evokative, një imazh magjeps të hapësirës lirike. Te fundi, edhe shkrimtari Borges e dokumentoi se vetë imagjinata e poetit është poetike.

Në poezitë e tij, në përgjithësi, M. Bislimi shquhet për intuitë të veçantë krijuese, intonim të theksuar lirik, të thurura përmes një shprehjeje të

kursyer lakonike. Andaj, konteksti i tij lirik e lakonik zgjon asociacione të ndryshme kuptimore-metaforike, gjithnjë më të thelluar në krahasim me përmbledhjet e më parme, ku fshehtësia e magjisë dhe domethënia e verbit nuk mund të rroket gjithaq lehtë.

Poenta kryesore e mesazhit poetik të autorit, apo parimi bazë krijues i tij, është lidhja e fortë emocionuese me atdheun, kohën dhe realitetin. Në këtë kontekst, shpirti i poetit përmban poezinë e jetës tjetër, që përthyhet nëpër artin poetik. Përmes kësaj, autori shpalos metaforën e mendësisë më tej se etnike.

Si pjesëmarrës aktiv i lëvizjes çlirimtare, që e vuajti më lëkurë, në poezi autori e shpreh dramën kombëtare nëpër shtërgata shekujsh, ku shfletohet historia e këtij trualli etnik dhe stuhia e saj simbolike. Kështu në ciklin "Madhështia e yjeve" ai poetikisht i skalit ca figura dhe çerdhe të rëndësishme historike kombëtare që kryen funksionin triumfues ose gjenden ende në shkallëzimin e mëtejshëm të piedestalit historiko-etnik, siç ishte heroi legjendar A. Jashari, Remzi Ademaj, Luan Haradinaj, pastaj, Kruja, Vlora, "Çamëria", Prishtina ("Hyrje në Pranverë") etj., ku pos tjerash, M. Bislimi e poetizon legjendarin Adem Jashari, "me syrin pishë e zemrën prush", ky hero:

"…më i bukuri yll gjithësie

kërthizë e atdheut lidhur nyje
mbaje fort në gji birin tënd
si lum për ty Shqipëria nënë!”

pastaj: Remzi Ademin / Petrit Kodrën, që “tokës sonë arbërore / përjetësisht / po i bëjnë dritë”, mandej “pas kushtrimit / gjithë një zëri/ Luan ishte vetëm njëri”, është kjo gjetje e papërsëritshme e autorit për Luan Haradinajn, si dhe qindra dëshmorë tjerë që nxorën Kosovën nga kthetrat e bishës serbe.

Vetë brumi i poetizuar në këtë përmbledhje, nxjerr në shesh metaforën epike të një lloji të veçantë, si risi në poezinë tone, siç është poezia “Ndër shekuj”, ku “pushtuesi e ka ngrënë kokën e vet”, pastaj si në ëndërr, ku vëllai e mban besën e dhënë motrës, motiv ky i zgjeruar në poezi folklorike, artistike dhe në prozën më bashkëkohore, sidomos te I. Kadare, pastaj “Vatër krenare”, “Rreze dielli”, “Pika loti”, “Hyrje në pranverë” (shpërthimi i demonstrative në Kosovë më 1981-9), pa i lënë anash edhe plagët po aq të mëdha, siç është “Çamëri”, “Vlora” etj. Të gjitha këto me synime të realizimit të aspiratës shekullore për një Shqipëri etnike, të përmbyllur përmes Krujës skënderbejane, Lidhjes shqiptare me seli në Prizren, Vlorës, Prishtinës së 81-shit, dhe së fundi Prekazit, të reflektuar përmes udhëtimit të flamurit me buzë në gaz. Aty shpaloset edhe harta metaforike e dhembjes së

lashtë iliro-dardane, dinjiteti lirik përballë dramës së etnisë, duke krijuar situata të përthyera përmes fitores së jetës ndaj vdekjes metaforike, deri te rrezet e diellit që s'e lënë poetin të vdesë, pa i parë ato. Andaj, sipas poetit, ende nuk kanë dalë rrezet e vërteta të lirisë, përderisa: "...gjaku im / Preshevë / Medvegjë / Bujanoc / Çamëri / Ulqin, janë krenari e gjallë, që presin ditë më të mira në hapësirën etnike; atje ku:

këngës ia thotë shqiptari ...
ku ka jetuar i pari
i rrënjës sonë të patretur
i rrënjës sonë të vjetër
nga Ulqini në Janinë
nga Medvegja në Prishtinë

(Vatër krenare)

Janë këto disa nga tufat subjektive të strukturës poetike të veprës së M. Bislimit, ku sitet drama tronditëse e përsëritur ndër shekuj, e fiksuar në hapësirën e fatit. Pos tjerash, bie në sy se autori sikur e njeh mirë pafundësinë e ëndrrës etnike, përgjithësisht njerëzore. Si i tillë, ai i shfrytëzon me mjeshtri nuancat më të rralla të fjalës e shprehjes poetike, të shkrira në një simbiozë metaforike.

Në vazhdim bie në sy një shkallëzim më cilësor i nervit poetik të autorit në shkallë

refleksive, një peshë më e matur shprehësie poetike. Në ciklin: “Urtarë mjekërbardhë” autori, pos tjerash, e modernizon shprehësinë e ideve poetike të “Shqypnisë së robnueme” të Vaso Pashës, e shkruar gati një shekull e gjysmë më parë, duke u bazuar se na ka bërë një nënë. Nuk është motiv i përsëritur apo i vjetruar. Vetë mosrealizimi i dëshirave të kërkuara kombëtare për një Shqipëri etnike që atëherë, fatkeqësisht, edhe sot e kësaj dite, është e pakryer. Andaj, pothuaj, të gjitha poezitë e këtij cikli i shërbejnë bashkimit shpirtëror e kombëtar në kornizat e së drejtës dhe të vërtetës njerëzore, se “s’ka gjë më mirë / kur s’kemi përse të frikohemi nga e vërteta e guximi / për t’i thënë gjërat me emrin dhe mbiemrin e vet. (E gjeta). Sipas poetit, kjo është “Bujari njerëzore”, madje edhe kur ata gjithçka dhanë për të tjerët dhe ndërruan jetën me lirinë, për ta gëzuar të tjerët (Botë e përtejme)

Aty haset malli i kursyer për atdhe, sepse, sikur autori duket se është shfryrë në përmbledhjet e më parme, por edhe pse i duket se nostalgjisë tashmë i ka kaluar koha, tani në kushtet e komunikimit bashkëkohor. Megjithatë, paksa prekëse, metaforike është edhe poezia “Të urtës nënë”, që mbetet në pritje për t’iu kthyer bijve të vet. Është një mall i metaforizuar i dhembjes së gjatë shekullore përcjellë me gjak e lot.

Autori di ta gdhend vargun e metaforën me një mjeshtri të rrallë poetike. Ai tashmë e ka

kapërcyer pragun e sprovave dhe e ka formuar individualitetin e vet poetik, me shtyllat: Zanoret e bardha, Malli i përflakur, Lirikat e fjetura, Tingulli i gërvishtur dhe së fundi Kumbim kambanash, të përcjella me kontekstin e frymëzimeve poetike.

Poezia e M. Bislimit vjen nga zjarri i zemrës, gërshetuar me realitetin jetësor dhe e shkrirë me metaforën e këndshme të stolisur me fshehtësitë e shpirtit të shprehur përmes tablosh poetike të kohës, jetës dhe të poezisë. Kështu:

burrat e motit
fjalën e dhënë për liri
nuk e mohuan,
me gjithë sakrificat.

(Sprovë)

Madje, as sot e kësaj dite, ata burra unin e vet nuk e qesin në lojë (Nuk erdha). Jepet një laryshi e begatshme temash poetike e pikturimesh shpirtërore të skalitura me mjete të pasura stilistike-poetike. Poezia e tij bulon atje ku syri i mprehtë i frymëzimeve shpirtërore vlon jo vetëm përmes reflekseve patriotike, por për të gjitha rrezet jetësore që e freskojnë lirinë njerëzore, madje edhe e shërojnë nga mungesat jetësore-kombëtare. Kështu, poeti thur lirika të së sotmes, qofshin ato të këndshme a të hidhura për kohë dhe

njerëz, gjithnjë duke kërkuar zgjidhjet fatlume, përkundër poezisë së Rilindjes, ku kryesisht kishin melodi vajtuese, duke mos kërkuar gjithaq shtigje për të dalë nga ajo amulli, me ca përjashtime te Naimi, Çajupi etj.

Vargjet poetika të M. Bislimit kanë një figuracion të pasur poetik e stilistik, mjaft të kursyer, të cilët me të shprushur, qesin flakë. Janë poezi të motivuara e të frymëzuara, që burojnë nga thellësitë e shpirtit dhe shkrihen në frymëmarrjen e kohës, madje dhe më tej se në truallin arbëror.

Shpirti poetik e atdhetar i poetit është i shkrirë në universin njerëzor të qenies kombëtare që synon tani një formësim të ri artistik e kombëtar, përgjithësisht njerëzor, kur kombi ende gjendet në një kryqëzim të një rendi të ri shoqëror ende të pakompletuar, ndërsa i kërkohet të mos e kthejë kokën prapa, me gjithë copat e lëna jashtë truallit, për të hyrë e për t'u shkrirë në vallen e madhe të një bashkësie me mungesa gjymtyrësie tokësore, kombëtare, shpirtërore etj. Për këtë, poeti porosit:

kohë dhe njerëz
ngritni zërin
mos heshtni kur gjëma mbi tjetrin bie
kur ngriheni në mëngjes
thoni me sa zë keni
o qafën e theftë
kurrë mos paftë ditën e vet

bukë e besë shkelësi

(Zërin e ngrita)

Ndërkaq, kjo pritje e gjatë shekullore, "... atë ditë / kur tek kjo derë / do bëhet i zoti / ...do thahet loti (Pritje). Realiteti i sotëm na tregon se ende jemi me sy të përlotur, por poezia po tregon rrugën e daljes nga kjo përlotje.

Pos tjerash, vetë malli i përflakur edhe si cikël më vete, sipas poetit, është rrjedhë e një gjendje jetësore kombëtare në rrugëtim të dhimbshëm, që kërkon një kahe të përskuqur edhe për të tjera dhembje. Prej këndej poeti na tregon "Portën e përgjakur": "…po kthehemi të përgjakur me lëmshin e mbledhur në grykë / po rikthehem / unë birit yt i tretur / flokë bardhë / e plak me mjekër / po kthehem tek pragu yt / me lëmshin e mbledhur në grykë..." (Porta ime e lashtë)

Në ciklin e fundit "Kumbim kambanash" poeti tubon poezi të zhanrit të ndryshëm, në mes tjerash:

"Stublla e gurtë
Stublla e murtë
në tokë kur Krishti zbriti s'pari
ku
e priti shqiptari.

i ndanin tokat e shqiptarisë

reliev gunga-gunga
të tkurri kaq shumë koha
të tkurri dhuna
toka që vazhdon të thërrasë
ku jeni o burra

(Tkurrje)

Cikli "Lirikat e fjetura", përbëhet nga poezi kryesisht me motive intime, ku poeti (mos i ngjaftë me jetë) sa janë të perënduara si lirikat e tilla të Migjenit (nga koha e kaluar e asaj shkalle rinore), po aq e njomin veprën me ndjenja intime të një stili të mëvetësishëm poetik. Po ashtu edhe cikli "Tingull i gërvishtur" përbëhet kryesisht prej poezive satirike, me theks kryesor:

për bijtë e lakmisë
çakërritur me gishtërinjtë e thatë
tapitë e humbjes së dekadave
po mbanin në duar

Në këtë vepër poetike, M. Bislimi përdor stil konciz me pasuri fjalësh e shprehjesh të figurshme e të spikatura. Figurat janë të lidhura me tematikën, gërshetuar me asociacione imazhesh. Poeti gjendet në rrugën e pasurimit të tipareve të individualitetit poetik, ecje drejt një shkalle gjithnjë më cilësore, krijuese i semantikës poetike,

begatuar me një figuracion të goditur e vetjak, me ritme e rima të larmishme.

Motivet e tij janë përcaktues të rrugës së tij poetike, gjithnjë në kërkim të individualitetit të tij, në bazë të burimit të pashtershëm frymëzues, në qasje me rrjedhat e kohës, brumosur me material jetësor, kombëtar, shpirtëror e refleksiv, që synon një sintezë të shkrirë me elementet estetike e metaforike, sidomos tani pas një gjumi të rëndë e të gjatë robërie, kur duhet luftuar për mëkëmbje, dhe për pavarësinë e pjesëve të mbetura etnike nën zgjedhë të huaj…

Te autori vërehen edhe prurje elementesh të reja poetike, në krahasim me krijimtarinë e tillë të mëparshme, gjë që flet për ambicie serioze, këmbëngulëse dhe avancuese të shkallëzuar me një talent në zhvillim e sipër. Ka edhe figura befasuese. Përdor një figuracion të thellë e të larmishëm metaforik, në harmoni me stilin konciz. Temperamenti impulsiv i poetit M. Bislimit është i gjallërishëm, ku detaji luan rolin kryesor organizues.

Prof. Dr. Zenun GJOCAJ

MADHESHTI E YJEVE

Legjendarit

kam pasur fatin
ta preku
ta shoh
ta njoh Komandantin
këtë burrë Shqiptarie
me shikimin lart
me zemër të madhe sa mali
ngrirë në bronz përjetësie
zemër trimi
zemër djali

pjesë e pandarë historie
atdheut kush më shumë i fali
dashuri
mustaqet varë deri në gushë
si lum për ty moj nënë Shqipëri

ndër yje
më i bukuri yll gjithësie
kërthizë e atdheut lidhur nyje
mbaje fort në gji birin tënd
si lum për ty Shqipëria nënë

më i bukuri bir i shqiptarisë
lis
më i larti ndër male
mustaqet varë deri në gushë

me syrin pishë
e gjoksin prush

Remzi Ademit
(Komandant Petrit Kodrës)

në pafundësinë e hapësirave shqiptare
shkëndija po i nxirrnin sytë
toka po digjej zjarr
ti në të parin fluturim
së bashku me shqipet e këtyre anëve
përqafove lartësitë
përjetësisht
flakadan lirie
tokës shqiptare po i bën dritë

mbi ty
mbi emrin tënd
mbi rrënjën tënde të lashtë
kurrë drita e krenaria mos u shoftë
përjetësisht rrënja e nderi t'u shtoftë
deri atje në majat e Pashtrikut
atje
ku është foleja e shqipeve
dhe streha e mikut
emri yt
Petrit
tokës sonë arbërore
përjetësisht
po i bën dritë

Luanit

me Shkëlzenin po rrugëtonin
nga moti në mot
si qielli i kaltër
rreze dielli shpërndarë
për botën liridashëse
mbi Shkëlzen e mbi Sharr

lulëkuqe të këputura
Shkëlzeni, Hakifi, Edi, Zahiri, Muji, Adriani...
pas kushtrimit gjithë një zëri
Luan ishte
vetëm njëri

Vatër krenare

krenari e gjallë
gjaku im
Preshevë
Medvegjë
Bujanoc
Çamëri
Ulqin

atje ku këngës ia thotë shqiptari
atje ku kam jetuar unë
ku ka jetuar i pari
i rrënjës sonë të patretur
i rrënjës sonë të vjetër
nga Ulqini në Janinë
nga Medvegja në Prishtinë
veç shqiptarit nuk ka tjetër
në këto troje
më të vjetër

Gënjeva

ah
më duhet të të gënjej
se i lumtur jam
se me lumturinë ngrysem dhe agoj
më duhet të të gënjej se pa ty atdhe
jeta gjallëron njësoj
më duhet të të gënjej
dhe për këtë
peshë e pendimit mbi supe
gjatë do më rëndojë

në fakt
të vërtetën ndryva
në gjoksin tim përgjithmonë
e nuk ta thashë dot
të vërtetën e madhe e di
vetëm shpirti im
dhe i madhi zot

Gjithmonë

gjithmonë do të kthehem tek ti
edhe pas vdekjes
toka brenda nuk do më lërë të qetë
nuk e di nëse unë ju mungoj
aq sa më mungoni ju mua
nuk e di nëse më doni
aq sa unë ju dua
nuk e di

peizazhe të atdheut
më çoni shpirtin peshë
më trazoni kaq shumë
unë shpirttrazuar
si hije
as zgjuar
as në gjumë

Pika loti

a thua kështu paska thënë zoti
të degdisur anembanë
pika gjaku
pika loti
na mbeti pa emër konaku
me peshën e vuajtjeve mbi shpinë
na mbeti shkret oxhaku

me zemër në plasje
Çamëri
Ulqin
Janinë
me lot e trishtim
dot nuk ju kthyem
pika loti
pika gjaku
na mbiu ferra te pragu

Çamëri

gjymtyrë e trupit tim
me plagët e ndarjes mbi shtat
që nga dëbimi i parë
dhembje e gjatë
pengu i shpirtit mbetur varë
Çamëri
mos vdeksha i ri
pa hequr vetë me dorën time
në arat tona
brazdën e parë
në tokën boshatisur
parmendë e vjetër
shenjë gjallërie e një kohe tjetër
zotin e madh e kemi dëshmitar
Çamëri
mos vdeksha i ri
pa ardhur tek ti
tek porta jonë e vjetër
tek të parët tanë
tek foleja jonë
nën atë çati
ah
Çamëri
pengu ynë i përjetshëm
plagë që djeg në gji

Nëntori

nga qielli
zbritën legjendat
lindën kuçedrat
zbardhi dita jonë
në palë të flamurit erdhi djali
në nëntor
u gëzua mali
për tokë e qiell
për Shqipëri
nëntor ka
vetëm një

Ndër shekuj

hallakatjet e erërave trazuan
rrugën tonë të madhe
ndër shekuj
të parët historinë bëmë
Milush Kopiliqi
i pari
me dorën e vet
vrau ëndrrën e pushtuesve
sulltanin e mbuloi bari
tokë e mbushur me kocka
tokë shqiptari

kokën e vet
pushtuesit kanë ngrënë
këtu zot
vetë
shqiptarët janë

Me gjuhën e vet

asht i vjetër kërcor
nga dheu nuk tretë
dëshmi e kohës
me gjuhën e ashtit që flet
në tokat tona të zhuritura
sakrificat mbinjerëzore flasin
me gjuhën e vet

nën peshën e dheut
ku ashti ynë tretë
kohët e një mbijetese të skajshme
peshë qëndrese e pakapshme
gojëhapur arkeologu mbet
ashti ynë
nuk ishte kalbur
as ishte tretë

Si në ëndërr

kush di t'i zbërthejë ëndrrat
kush fatin mbi to mbështet
nga ëndrrat ikim
si në ëndërr kjo jetë
qofshin ata
amen
qofshim vetë

na duhet kohë
që ta sjellim në kala
nga fundi i botës Doruntinën
vëllai ngritur nga varri
erë dheu po vinte
po vinte erë bari
prej kohësh
vëlla e motër
të djegur malli

në kërkim të pafajësisë
u ngritëm edhe nga fundi i dheut
besën e dhënë
peng nuk e lamë
motrat i sollëm në gjirin e këngës së lashtë
si në ëndërr
erdhëm edhe nga bota tjetër
fluturim me atin e bardhë
përballë motrës

fjalën e dhënë
peng nuk e lamë

Sa mali

rrallë ka për të rënë të dëgjosh
kur të tjerët thonë
ishte i madh ai
sa mali

që të mos u hyjmë në hak
të jemi të sinqertë me ta
ta vemi dorën në zemër
e të mos bëjmë mëkat
para zotit e robit
djemtë që ranë në zemër të malit
për ty
për ne
për mua
për atdhe
madhështia vjen nga përcaktimi
janë të mëdhenj ata
të mëdhenj
sa mali

E tillë ishte jeta

për një moment stepa
dhembja ashtin ma shpoi
tani
ashti im i mplakur
peshën e dhembjes s'e duroi

netët e gjata pas grilave
më të ndriturit mes kandilave
flakadanë lirie
idealistë të pamposhtur
këmbëngulës e të pareshtur
të rreptë si rrëfeja
përherë
portën hapur kemi mbajtur
bukë e kripë
me zemër në dorë

e tillë ishte jeta
në arratisje
në burgje
në mërgim
poemë pa metaforë
poemë pa dekorata e çmim
bijtë e Shqipërisë
pjesë e historisë së pashkruar
bijtë e kësaj toke
harruar e lënë me një anë

sfiduesit e robërisë
bijtë e tokës nënë

Hyrje në pranverë

pranë dritares sy hapur
nga majë e pemës
u ngrit zogu në fluturim
me krahët e butë
borën e bardhë shkundi
pranvera po vjen
më në fund
edhe në qytetin tim

po
po vjen marsi i trëndafilave
afshi i ngrohtë tokën puthiti
një lirikë
për bisqet e pemës
po ndihet frymëmarrja e blerimit
ngrohtësi e stinës ripërtëritëse
stinë e lulëkuqeve
të marsit të parë

Prishtinë kujto me dashuri
kujto
stinën e trëndafilave të kuq lirie
Prishtinë ata ishin të rinj
si trëndafilat
që ranë në pranverën ‘81

Vlora

në rrugëtimin tonë të gjatë
kot nuk shkuan trimat
me vrap deri në Vlorë
një copë flamuri
për ta sjellë në Kosovë
epopenë e këngës njëqindvjeçare
e sollën selamlabët
e sollën gunëbardhët
e sollën tek Jasharët
e vunë mbi kullën prej guri
nga Vlora në Prekaz
njëqind vjet rrugëtoi Marigo
rrugëtoi
me buzën në gaz

Rreze dielli

bëhem një me terrin
pres dritën
dritën e agut të parë
mbi majat e shkëmbit të vjetër
ti rrezon ngadalë
atdhe
po pres që sa vite
rrezet e para
rrezet e lirisë
ditët e mira të shqiptarisë

ngrohtësinë e lirisë
afshin e saj po e pres
ti ec më shpejt pse nuk vjen
kockat nuk më mbajnë
nuk dua të vdes
të vdes
pa të parë të lirë

Kënga ime

ata ranë ditën me diell
me besimin tek zoti dhe liria
nuk u ankuan kurrë nga jeta e rëndë
jetën e çmonin më shumë nga ne
mbi të gjitha e çmonin lirinë
të cilës ia falën edhe jetën

ata ikën
mbase me të vetmen brengë
së nuk do të jenë gjallë
kur atdheu do të jetë më i mirë
më i bukur
i çliruar
përfundimisht i bashkuar

kjo ishte aspirata e tyre që nuk u përmbush
deri në përmbarimin e saj
ata prehen të qetë
por prehja nuk i qetëson

këngë ime
këngë e vjetër
veç teje këtë natë nuk gjeta
jo
nuk gjeta
prehje tjetër

Numra

të tjerët nuk na kuptuan kurrë
pa dashjen tonë
ata në lojë na vunë
rrethuar me emrat njëjës
prapë si dikur
shumica e të përvuajturve
shpërndarë anembanë
si numra pak
si dikur
të anatemuar prapë

numra që gjithmonë
ishin më shumë se një
me shpresën nën dhëmbë
nuk u dhanë
nga një kafshore bukë
e hanin në këmbë
na përbuzën bukëshkalët
prapë
numra në ngritje
që atdheut kurrë
nuk i kanë hyrë në hak

URTARË MJEKËRBARDHË

Mesazh

me engjëj e profetë jam
gjakun e Krishtit e Muhametit kam
jam me kishë e xhami
me më të mirët e kësaj bote
me rrënjën time të lashtë
jam
me shqiptari

idhuj të vendit tim
kulturë gërshetimi në kërthizën e tokës sonë
nga lindje në perëndim
sa admiruese si askund në botë
tokë e ashpër
paqe shpirtërore të përjetshme
popullit tim
gjunjëzohem para bindjeve të motit
para juve
para shtëpive të zotit
njëri tjetrin mos ta ngasim
së bashku
botën e vjetër ta vrasim
të krishterë e myslimanë
shqiptarë kudo që jeni
na ka bërë
një nënë

Ai

ishte më i veçantë nga të tjerët
i tillë ishte ai
tjetërsimin nuk deshi
i qetë si oqean
ai kurrë nuk tha
ja ku jam

e gjenim kur na duhej
ku ishte e ku nuk ishte

një ditë
kur
askujt nuk iu desh më
ai prapë i madh mbeti
mes njerëzve e para zotit
ishte shumë njerëzor
nuk përkulej para sfidave të motit
ishte burrë
mjekërbardhë
si bjeshka me borë

Mure

në kërkim të një ndarjeje të përjetshme
mure të larta kishte ngritur
me gurë të lashtësisë
në qepallat e vashës
pamëshirshëm kishin goditur
këngën e dashurisë
sot e dje
pa llogaridhënie
cilës kohë i takuan ata
e cilës ne

enigmë e pa zbërthyer
mbështjellë me vellon e verdhë
muret e ndarjes
ngulur kaq thellë
në zemrat tona
as i hoqëm
as i vumë
as i poqëm
as i rrënuam

Syri i keq

syri i keq
mos të paftë
lutemi me gjithë shpirt
mos të marrtë në shënjestër
e liga
gurit i raftë
orë e zezë qoftë larg
sa borxhe kemi për të larë
e kujt s'i kemi hak

para njeriut e motit
hyut i mbetemi kot në qafë
para motit e para zotit
shpirtndritura na fali
zemrën e madhe të dashurisë
në qafë nuk morën askënd
engjëllor
bijtë
dhe bijat e Shqipërisë

Mes miqsh

mes miqsh e njerëzish të thjeshtë
shokë e kundërshtarë
ëndërrimtarë bjerraditës
këmbësorë e kalorës me atin e bardhë
njerëz me këmbët në tokë
e mend në kokë
urtësia qoftë me ju
në kohëra të pakohë
shtegtarë të vonuar
me eshkën e ndezur në dorë
stërgjyshërve të lashtë
shpirti dritë u pastë
mes miqve na lanë

Dashuri

njerëzinë dashuronte
lum e krua harronte
pranë burimit
zemër trazuar ngrihej si n’ jermi
etje kishte
kishte uri
për botën e dashurisë njerëzore
pas muzave prehur
pas huqeve dehur
vetën kishte lënë pas dore
nuk dinte për urrejtje
dinte
vetëm për dashuri

Askush si ai

me të gjithë
për çështjen e madhe shtrohej
adhuronte mendjendriturit
të njerëzishmit i donte njësoj
nuk mbante shkëlqimin për vete
atdheut shkëlqimin ia dëshironte
askush si ai
të vërteten e madhe s'e mbronte

biri i tokës mëmë
modest
e
madhështor

Një shenjë

lajmi i mirë i një ftese
që e prisnim kaq gjatë
rrugë të gjatë do marrim
drejt malit të lartë

kishim shumë punë
shenjë e gjallë për ne
gjëra të pathëna u thanë
mes asaj që duhej thënë
dhe asaj që ishte e ndaluar
gjuha përshkonte
tehun e shpatës
në mos
ta shkurtonin diellin

takimi me të humburit
na solli në vete
ringjallje e datës së kallur
që nganjëherë s'vjen për mirë
toka nën këmbë po na lëkundej
koha e shenjave të liga
që joshin të luhaturit
mashtrim ky
që u doli hakut

Ky vend

ky vend
me vlera kaq të vogla materiale
këta njerëz
me vlera kaq të mëdha shpirtërore

e saktë
i varfër e shpirtmadh
janë të paktë këta
janë me fat
mbi parimet e të njerëzishmes
veprojnë
në të mirë të atdheut
më përkushtim punojnë
të varfër pambarimisht
të njerëzishëm
përfundimisht

Pranë sofrës

me sjellje urtari
ulur pranë oxhakut
mes halleve njerëzore
me ritmin e arsyeshëm
po rrah zemra e plakut

pranë sofrës së vogël
ulur jemi
bukë e kripë kemi
mirë se erdhe njeri
se njerëz na duhen
në këtë kohë
kaq të panjerëzishme
eja ulu pranë sofrës
ka kohë që po presim
birin e tokës

E ndiej

nder deje diçka më rëndon
diçka e pa thënë
sa pesha e gurit
diçka e rëndë
e ndiej

ti nuk je guximtar
aq sa ta pranosh pendimin
tjetërsimin tonë para hyut
para shenjtit shpirtëror
unë e ndiej
ti nuk e pranon
borxhin e pakryer
mes katër rrugëve lënë

kush nuk e ka guximin të pranojë
si besimtar e burrë
ikjen nga besimi i parë
as të krishterë
as myslimanë
tamam
rob i zotit mes rrugëve lënë
peshë e kryqit prej guri
lënë anash
e ndiej
ashtin që më shpon
për fjalën e pathënë

E gjeta

respekto gjykimin e tjetrit
për të tjerët
mbështetur mbi parimet etike
ta themi të vërtetën
për të tjerët
ma shumë për veten
nga lustrat të lirohemi
të themi me sa zë kemi
e gjeta

nuk ka gjë më mirë
se kur nuk trembemi
nga e vërteta

Përzierje

sonte do iki
në kahun tjetër
nga andej
ku shkon njerëzia
me ndjenjat e përziera
do marrë rrugë

kisha menduar të largohem që moti
nga pikënisja ime e parë
me mesazhin e vonuar të pritjes
që mbaja nën sqetull të gjallë
të ndërroj rrugë këtej
apo në botën tjetër

nuk e di
nëse janë të lavdëruar para zotit
ata që i bien ndesh mohit
në motet e liga
e motet e mira
ndërroni rrugë o njerëz
mos ndrydhni kohën kot
me ndjenja të përziera

Çuditërisht

me dashje do thosha diçka
sikur ta gjejë atë
që të tjerët nuk e kanë thënë

çuditërisht
nuk kishte mbetur as edhe një pëllëmbë vend
rrugën kishin zënë thashethemexhinjtë
mbi atë që nuk shkruhet
e që nuk thuhet

çuditërisht më kishte shtënë forca
e muzës së parë
që u përmbyll me një zanore
prapë
të njëjtit njerëz
gjëra të njëjta po thonë
për një botë të tërë keq po flasin

çuditërisht
vetëm ti
ke diçka që të tjerëve u mungon
qartësia e gjuhës me të cilën flet
guximi për t'u thënë gjërave
në emrin e vet

Bujari njerëzore

në jetë kanë punuar njerëzisht
me dashje
tokën nuk e kanë shkelur rëndë
me njerëzit
janë sjellë përzemërsisht
as thneglat s'i kanë shkelë me këmbë
askënd nuk e kanë ngacmuar në jetë
askujt s'ju kanë drejtuar me gisht

me punë të ndershme
kanë ngritur folenë e ngrohtësisë
janë përpjekur për vete
për miqtë
për atdhe-në
për tokat e shqiptarisë
në qafë askujt nuk i kanë rënë
në rrugët e jetës
brengat kanë ndrydhur me dhëmbë
e qarë nuk janë asnjëherë
në heshtje e pa zhurmë
kanë hedhur hapin tej
rrugëve të jetës zvarrë nuk janë heq'
në këmbët e veta kanë ecë
me barrët e jetës mbi supe
askund pa u mbështetë

në konakun e ngrohtë

pranë oxhakut
bukën e djersës së vet
pa ndrojtje kanë ngrënë
në shtratin me kashtë
gjumin rehat kanë bërë
në këtë jetë
borxh kujt nuk i kanë mbetë
në hak kujt nuk i kanë hy
të ndershmit bijtë e nënës sonë
bijtë e rrallë
të nënës Shqipëri

Botë e përtejme

hamendshëm e rrugë ngatërruar
sprovë ndjenjash zhgënjimi
në përballje me padrejtësitë
që koha i solli në sofrën historisë
ata nuk u nënshtruan
kurrë nuk ndaluan hapin
në kërkim të dashurisë njerëzore
për ne
për të njerëzishmen
bënë të pamundurën
ata
si dete
gjithçka dhanë për të tjerët
ata
nuk mbajtën asgjë për vete

ZANORET E BARDHA

Kthehu

kthehu
të të përqafoj së bashku me lumturinë
kthehu
veç edhe një herë
kthehu

në arkën ku kujtimi ndryrë mbeti
ku dikur u mbyll ajo derë
ku pengu i dashurisë nuk u vyshk
si gjethe e verdhë
rrahur nga erërat
degdisur në heshtje
kthehu

jeta të mori nën sqetull
pluhurin e kohës davariti
kthehu tek pragu i këngës së vjetër
tek ajo strehë
ku së pari hodhe lirshëm
këmbën e vockël mbi dhe
ktheu

Abuzim

në emër të zotit
në emër të ligjit
në emër të kodit
në emër të mëshirimit
në emër të motit
në emër të drejtësisë
çka nuk po veprohet

edhe në shtëpitë e perëndisë
abuzim
zoti sehir po bën
njerëzit kundër njerëzve
nam të zi po lënë

Dritëro Agollit
(në tetëdhjetë vjetorin e lindjes)

poezinë shfletova me kujdes
atë e gjeta aty
në botën e madhe me halle
pranë tryezës
poetin me zemër të madhe
Dritëro flokë e zemër bardhë
fanar
po kërkonte diellin
po kërkonte ai
mallin e muzës së parë

rrugëtim kaq i gjatë
me trastën e vargjeve mbi shpinë
pa gjumë e fillikat
net të tëra zgjuar
zgjuar si "lugat"
pa zhurmë
kaloi pragun e moshës së bardhë
iku
dhe erdhi bashkë me lulet e prillit
Dritëroi që po matej
me rrezet e diellit

Shtegtim

kokën kam vënë në prehrin e lashtësisë
udhëtoj pafundësisht në oazën shqiptare
ku prek trëndafilin me vesë
me gishtërinjtë që dridhja i tradhton
lot e vesë u bënë bashkë
dhimbja që thellë më shpoi
thellë
deri në asht

lojërat e fëmijërisë shqip gumëzhijnë
në kujtimet e mia
eh ç'mu këput diçka e krisi
nga gjoksi im
diçka si degë lisi
që bie me dhimbje e rrapëllimë
e rëndon si guri
mbi varrin tim ku dheu
vend nuk zuri

plagë e përjetshme në kraharor
mbeti
mbeti mbi gjoks një dorë
një dorë e ngrohtë kujtimesh
në rrugët e pafundme shtegtimesh

Toka jonë

e djegur me shkurre
me varre e lule
përtej
shtatë malesh e kodrash
ku rrapi shekullor
rrënjët thellë ka lëshuar
ku gjaku pikon
mbi kalatë e gurta
tokë jona e pamatur
të ligjtë të ndanë
e ne
kot
pse po na mban

Lajthitje

a thua të ketë mbetur
diku
pak ajër të freskët për ta thithur
sa për të hapur mushkëritë
një parandjenjë joshëse
më vuri në lajthitje
me besimin se diku do të ketë njerëz të mirë

sot
kjo aventurë e pështirë
e ndiej
nga do që shkoj
e ndiej
ani pse
nuk e besoj

Sprovë

mes sprovash të vështira
rrugët e jetës të kalisin
mesazhin e dashurisë përhapni gjithandej
maje kokës mbani të bardhë plisin
mos u mahnitni pas fijeve të përjetësisë
mos e ligështoni fisin
arbëror

ai
me dorën e vet burrërore
mbolli fidanin e parë
në kopshtin e dashurisë
në vatrën e prushtë shqiptare
atdhe
me besën e dhënë për ty
për besën u dogjëm
fjalët mbrapsht s'i hoqëm
deri në amshim
ku rrugët e jetës po ndaheshin
përgjithmonë ikën
shkuan
burrat e motit
fjalën e dhënë për atdhe
nuk e mohuan
u kalitën bijtë e tyre
nga etërit mësuan
dje edhe sot

atdheut
me i dalë zot

E tha

ndershmërisht e tha
m’i gjeni njerëzit e sinqertë
dua t’i takoj diku
të shpëtoj prej kësaj brenge
që na hëngri

e tha
m’i gjeni ata
kokën time lë peng
e tha
me gjithë mend
plotësisht e besoj
ani pse kjo datën kallë
ku t’i gjejmë ata sot
janë shumë të rrallë

Nuk erdha

unë nuk erdha tek ty
me dashje
pritjen ta bëra copa- copa

ti do mendoje mbase
ja
erdhi ky për të kërkuar diçka
jo
parimisht
në jetë
kurrë nuk kam kërkuar gjë
unin tim në lojë s'e kam vënë
as para teje
as para motit
as para zotit
nënshtruar para fatit nuk jam
nuk erdha
e nuk do të vij
me dashje
pritjen do ta vërë në çmendi

E vërteta

thuaje një fjalë të paktën
sa për të mbajtur në mend diçka prej teje
edhe kështu
lakimeve nuk iu shpëtove dot
ke parë ti ndonjëherë
të vërtetën duke shëtitur rrugëve të kryeqytetit
nëse po
na thuaj
nëse e vërteta ishte lakuriq

nëse jo
ti
paske ikur nga e vërteta
praktikisht
të dy paskeni ikur nga njëri- tjetri

borxhin ndaj botës së moralshme
nuk e paske larë
e vërteta me petka veshë
ti mes të ndershmëve
lakuriq
me ndërgjegje zhveshë

Gjeneratë

kronikat e historisë
në gjirin e tyre s’na futën dot
ishte kohë e pa kohë ajo
mes gjithë atyre përpëlitjesh
a thua
na shkoi mundi huq
a thua
na shkoi mundi kot

sa më vjen keq
në pritje të kohëve tjera
nuk kishim dëgjuar më parë
ata që e shpërbënë historinë
si për habi
i dolën prapë asaj në ballë

e tmerrshme
lisi i vjetër rrëzë malit
më rrënjët në tokën e vet
historinë që po vonon
me ndrojtje po e pret

Zërin ngrita

zërin ngrita mbi dhe
arsyeshëm për t'ju thënë
nëse nuk më besoni
eh
çiltërsia shpirtërore nuk më lejon
nuk flas
se brenga ime
flet vetë

mendoj ndryshe nga ç'mendoni ju
flas ndryshe nga ç'flisni ju
veproj ndryshe nga ç'veproni ju
punë sizifi
kohë dhe njerëz
ngritni zërin
mos heshtni kur gjëma mbi tjetrin bie
kur ngriheni në mëngjes
thoni me sa zë keni
o qafën e theftë
e kurrë mos paftë ditën e vet
bukë e besëshkelësi

Mendjemadhësia

eh
tani duhet të kemi frikë
nga kujtesa e së kaluarës
në thyerje e përbuzje
halle që njohu shqiptari
atëherë
harresa mos të na mbulojë
kur për një pikë ujë
për një pikë liri
për një fjalë të mirë
të vinin në kllapa

me zemër të madhe
ngadhënjyem mbi peshën e robërisë
varfërinë shpirtërore shporrem
uroj
mbi supe të mbajmë
peshën e ditëve të mira
uroj
të mos na lajthitë mendjemadhësia

Të gjallë

pas kaq vitesh papritur
ti
serish shfaqesh në ëndrrat e kopshtit tim
eh
të gjallë e të patretur
dhembjet e fashitura m'i ngacmove
të humbur e të pa gjetur
strehëve të këngëve të harrimit
nën çatinë e shpirtit
të pata fshehur diku
koha kishte ngrënë kujtimet
si ndryshku
rimat e këngës sonë të kahershme
që moti nuk janë kënduar
këngët që koha s'i vyshku

a thua do të ketë nota që artikulojnë melodinë
në gojën e pranverës së parë
kur ti ike
këngën e lë vetëm
e nuk u bëre më e gjallë
si kujtim
lulet mbeten
me shijen e aromës së parë
eh
të gjallë

Zotin dëshmitar

zemër në plasje zana të shitoftë
kënga t'u zanoftë
me shpirtin nën dhëmbë kam gërmuar
shtatë pashë nën dhe
vargun tënd për ta gjetur
për të të gjetur
edhe atje
ku nuk je

me gjymtyrë të përgjakur
në rrugëtimin tonë
drejt diellit e lirisë
tek pikësynimi ynë i përbashkët
falë bijve të shqiptarisë
dorën në zemër
zotin dëshmitar
gjatë rrugëtimit kemi hasur
shqiptarë
e shqiptarë

Kërkojë falje

kërkojë falje
bukën time të ngrohtë pranë oxhakut
dua ta ha rehat
nën çatinë e shtëpisë sime të lashtë
shtrirë gjerë e gjatë
në shtratin prej dërrase
të mbushur me kashtë
do pushoj i qetë
rrethuar me ëndrra të padjallëzuara
kërkojë falje

as kur jam zgjuar derën nuk ua hap
makthi i ligësive
ëndrrat m'i vret
dua të lirohem vet
dua të lirohem përfundimisht
nga njerëzit e ligj

sinqerisht kërkoj falje
nga ju o njerëz të mirë
nga ju o shokë
nga ju o të dashur miq

MALLI I PËRFLAKUR

Trokitjet

pahetueshëm kishte vu dorë vetmia
tek porta e shtëpisë
në tentim për të lidhur fijet e këputura
mes kohës që kishte ikur
dhe asaj që kishte mbetur
si në trajektore
po ndiqnim njëri-tjetrin

tek porta
lojërat e shkapërderdhura të fëmijërisë
kujtonin një kohë lumturie
të largët mbase
tani ai
me cigaren mes gishtërinjve të verdhë
i rebeluar si hije e venitur
po rrinte në pritje
tek ajo derë
ku trokitjet më nuk po dëgjoheshin
kohën po maste me trokitje
akrepat e orës së vjetër
në rinisje
në pritje
të një trokitjeje

Si trëndafili

për habi
edhe këtë ditë
prapë
ajo u zgjua kaq herët
mes nesh ajo vet
më e bukur se trëndafili
që jeton
vetëm një mëngjes

në kopshtin e dashurisë
ti lulja me vesë
ku petalet për dhe kishin rënë
luteni
mos i shkelni
mos i shkelni lulet më këmbë

Enigmë

nuk e vërejmë
se si kureshtja të bën për vete
enigmë mbi hyjnitë
mbi natën e ligë
dikush po hallakat motin
dikush
i mbështjellë me enigmë
po gërmon kotin

sa më e madhe greminë e enigmës
aq më e madhe kureshtja
dhe hallakatja e motit
realitetin për ta shtrembëruar
kureshtjen për ta hutuar
këta ditëhumbur
këta ditëverdhë
një jetë të tërë
me enigmë mbështjellë

Të urtës nënë

lëvizte kujdesshëm me hapat e lehtë
në oborrin e lulëzuar të shtëpisë
dorën vënë mbi ballë
e në soditje
me aritmi zemre në pritje
të kthimit të bijve të saj
përtej avllisë
po fshinte fshehur lotin e saj
me cepin e shamisë

eh
ato pritje të gjata
në rrugëtim na zu nata
të dy palët
pa gjumë
ne
dhe nënat që i duam aq shumë
të urtat nëna
për ju
s'do shteret kënga
kurrë

Fëmijërisë

retë e bardha të kujtimeve
po shkapërderdhën ngadalë
fëmijëri me lecka mbështjellë
kujtime
sa një mal
ndryrë në gjoksin tim thellë

kur kokën mbështetnim në prehrin e moteve
me dorën e saj nënëlokja
tufën e flokut na ledhatonte
me fjalën e saj të ëmbël
na ndalte çurgun e lotëve
kur lëndoheshim së vrapuari
pas joshjeve fëmijërore

ishim fëmijë
nuk ndaleshim kurrë
kohë në ikje
kujtime në fikje
tek varri yt nën atë rreze
një lule kishte nxjerr kokën mbi dhe
fëmijëri e largët se ç'na ndeze
për nënëloken e pavdekshme
kujtimin për të

Në krahët e këngës

erë e myktë e kohës së rëndë
erë myku e robërisë
rrethuar me hekur e zjarr
bijtë e shqiptarisë
nën klithmën e zhgënjimit
qiell i kuqrremtë mbi tokën e zhuritur
pushtuesit ndoqi
kalorësi ynë mbi kalë
në krahët e këngës
me gjoksin e tij valë

në krahët e këngës shaluar fluturimthi
si era iku
në bebëzën e syrit loti
si vesë mëngjesi
nga gjethja e lisit piku

aspiratë shekullore
në dridhjen e buzëve të vashave
lëmsh i mbledhur në kraharorin e nuseve
peshë e mallit tonë të djegur për liri
të kthyen në gjirin e këngës
së bashku me trimin
të kthyen
edhe ty

sakrificë
krenari
vetëmohim
kush si dorë e saj e lehtë
tek foleja ku fëmijët e trimit po rriten
si era
atje ku ajo nuk braktisi folenë
së bashku me ninullat e nënave për fëmijët
erdhi edhe pranvera

fëmijët e trimit u rriten
u rriten si era
shkëlqim e bardhësi plisi
ishte e madhe ajo
më e madhe se lisi
ajo
folenë e trimit për të gjallë
nuk e braktisi
ajo
më e madhe se lisi

Këngë

këngë e burrit është vaji
thoshin pleqtë dikur
na porositnin ata të mbaheshim
kur të na zërë e liga
mbahu
e bëhu burrë

pa varr e nishan nizam i vjetër
këngë e djegur
tek strehë e lashtë e shtëpisë
kthehu
kthehu o djalë i Shqipnisë
se po të presim që treqind vjet
treqind vjet po të pret
pajë e vashës
si zogu në pemë
këndon a vajton ajo kukuvajkë
rrem më rrem
këngë e saj
këngë e vaj
toka mëmë po pret
po pret që sa vjet
bijtë e saj

Sykaltër

vështrimin përtej detit kishte hedhur
eh rrugë e shkretë në mes këputur
rrugë
përgjysmë mbetur

atje ku ai pinte ujë burimi
ajo po e priste trimin
rrugë
ngatërruar mes ëndrrash të vrara
sa s'plasi prej trishtimit
në prehrin e legjendave
trimi i saj kishte fjetur
sykaltër si deti
si lumi
në gjirin e këngës përjetësisht
trimin e saj
e kishte zënë gjumi

Çaste

me gjithë shpirt
do të lutem për ty
për ata
e
për të gjithë ne
kur të vijë kohë e ndarjes
të mbajmë mend diçka
të paktën nga çastet e përplasjes
mes nesh

mbi gjurmët e lashtësisë
një kujtim
mos të lëndohet askush
atje ku i kishim caktuar
shtratin gurit
ku fle i qetë shpirti im
për pak çaste
në këmbë qëndrova
gurët e atdheut për t'i nderuar
shpirtin tim
pak
për ta qetësuar

Pritje

sonte nuk do të flas më shumë
sonte do të pres në shkujdesje
pa gjumë
deri sa të zbardhë

për të të lavdëruar nuk kam
as nuk të shaj
në pritje për triumfin tënd
vendi s'po më mban
nuk do bëj gjumë
as net të tjera
deri sa ti nuk i buzëqesh jetës
deri sa edhe për ty
nuk do të dalë pranvera
në pritje

Për ditë

për ditë e nga pak po zvogëlohen
hapësirat e kohës së butë
ashpërsi e mortit
matemi me hijen
mbi lëndinën e lotëve
burrëri e hequr në kandar
mes kockash shkapërderdhë
lulet që u thanë nga loti
një pikë uji
mbi plojën e verdhë

një ditë
do rinohen ato
atë ditë kur tek kjo derë
do bëhet i zoti
atë ditë
do thahet edhe loti

Malli

bashkudhëtojmë rrugëve të qytetit tonë
kalldrëme që i kemi shkelur dikur
së bashku me këmbë
si në ëndërr i pashë
i pashë mbrëmë

këngë e vjetër
që nxjerr vrerin e heshtjes
mbi melodinë e fatit të djegur
eh
si në ëndërr
ti fluturon mbi re të bardha
e njerëzishme hijelehtë
butësi shpirtërore mes yjesh
si ylli që shndrit

kohë e butë në davaritje
që mallin nuk e tretë
ti drenusha e malit
e bukura e dheut
që more me vete peshën e mallit
mallit
që ende s'u tretë

Porta ime e lashtë

shumë herë jemi ndarë
e vetëm të kam lënë
vetëm fillikat
në rrugët e fatit e të fatkeqësisë
në rrugën e gjatë
si thika në zemër
fat i lidhur me zinxhirë
me shpirtin nën dhëmbë
me mendjen tek ty
e kam pasur rëndë
e kam pasur vështirë

po kthehem ngadalë
tani
nga anët e botës rrugë humbur
tek porta e atdheut
i heshtur
do trokas në dyert e nisjes
nga ditët e largëta të braktisjes
po rikthehem
unë
biri yt i tretur
flokëbardhë e i mplakur
me shtat të përgjakur
po kthehemi tek pragu yt
me lëmshin e mbledhur në grykë

Guri

bota ime profane
po
ti ke halle
me keqardhje
jam kaq i pafuqishëm
për t'iu dhënë rrugë atyre
kush hap e mbyll dyert e mortit
në përballje me të papriturat
rrugë morën ata
ngatërrimi i mbështjellë
me lakuriqësinë e kohës së vrarë
ky gur memec
heshtur e hije vrenjtur
a do të futesh në dramë
në histori
legjendë a mitologji
ti gur i vendit tim
ti gur i nënës Shqipëri

LIRIKAT E FJETURA

Orë e vonë

hyre në portën e shpirtit tim
e ndrojtur
në këto orë të vona

ti
hije e pambrojtur faqe murit
në pafajësinë tënde degdisur
kush të goditi kaq padrejtësisht
këtë damkë kaq të zezë
kush ia dha
ëndrrës sate të brishtë

ti
gërvisht të kaluaren tonë
mes shpresave të këputura në mes
me ritmin e orës së vonë
ku akrepi ndaloi
me kujtimin e saj tretur
mbeti ndalë përherë
akrepi i orës së vjetër

ti
pranë dritares së vogël
ku qiriri flakët lëkund në përpëlitje
kush po i trazon ëndrrat tona
të kohës së largët
që gjumin prishin

të kohës në kusuritje
ne dhe koha
të dy në pritje

Nuk dua

nuk dua
që vargu im
në vete të bartë
peshën e shqetësimit
nuk dua të shprushë
në ëndrrat e bukura të jetës sate
sylarushë

ylli yt vezullues të ndriçojë përherë
të rrugëtojë lirshëm hapësirave kaltëroshe
të shkëlqejë më shumë
ngase dëshiron
ti
më e bukura mes shoqeve
nga do që shkon
vetëm ti
para yllit të mëngjesit
me flokun e shkapërderdhur mbi gjoks
agon

Një ditë

një ditë shtatori të takova
atë ditë
ëhë atë ditë

kujtimet fiksuan peizazhin e vonë
një ditë dhe një herë
në shtator dashurova
dhe një ditë tjetër
shumë më vonë
u ndeshëm prapë
nën strehën e vjetër të ëndrrës sonë
u ndeshëm më kot
dhembshurisht
ishte tepër vonë

Lozonjare

vardisur pas këngës si sorkadhe
të bukurat lozonjare
në valle
ngjeshur në radhë
aritmi
në gjoksin e saj
me zemër të kuqe
ai po bëhej dhëndër
ajo nuse
lozonjare gushëkuqe
vallëzo
mos ndalo
rrugë të gjata ka jeta
jeta
ka rrugët e veta

Lule bardha

as atëherë
ti nuk mbaje gërsheta
me flokun e zi mbi supe
mes qindra lulesh të gjeta
me ëndrrat e bukura na lidhi jeta
dhe ëndrrat i zuri mynxyra
enigmë e fatit pa zbërthyer mbeti
ndjesi e butë
e çiltër ishte rinia
as atëherë
ti nuk mbaje gërsheta
ku do varej dashuria
bengu i kohës që gërvishtë
në kujtimet tona
kohë e vrazhdë
kohë që nuk ishte
nuk ishte e jona

Dëshirë

nuk u duk
madje as sa për të dhënë kumtin
kokën kishte mbështetur në gjoksin e fatkeqësisë
për një kohë që ishte fishkur
për një kohë që nuk shpaguhej
për një kohë që nuk rikthehej
me atë pamje të veçantë
përzgjedhur sipas shijes së saj
dëshironte të mbetej e vetme
e vetme
si pranvera
në përpjekjet e saja
ambicie që nuk iu shteruan
pranverën për ta sfiduar

Si hëna

me dukjen e saj në horizontin e kuqërremtë
deri dje të kishin sharë
se na i mashtrove djemtë
si hënë e kuqe
moj
si nuse

e përflakur në qetësinë e natës
pamje magjike
këto gjetje të rralla
si hëna
na erdhi nusja moj mike
imagjinatën e krijuesit
mori me vete
diku larg e davariti
diku larg e treti
kur hëna nga malet zbriti

Këngë skofiare

e buta kënga ime
me kë do flas unë këtë mesnatë
në konakun e zemrës sime
unë dhe ti
flasim me belhollën
me syzezën
me bjeshkën dhe mollën
me lisat e gjatë
me kaltërsinë e lumit
thyejmë heshtjen këtë natë

kënga ime
këngë e vjetër
këtë natë
veç teje
nuk gjeta prehje tjetër

Sorkadhes

të panumërt janë ata që të këndduan
kënga për ty kurrë nuk pushoi
syëmbël
sybutë
sinonim i urtësisë
pritë të vunë të rinjtë
verbuar nga bukuria jote
iu plasën mushkëritë

ti
e ndruajtur si gjithherë
nuk re në pusi të dashurisë
sorkadhe
kush vrau butësinë tënde
e vraftë dorë e motit
guri ballërrudhur i shpuar
i shpuar
nga kripa e lotit

TINGULL I GËRVISHTUR

Shokë

ka shumë kohë që s'ju kam parë
shtegu i lotit më është tharë
rrugë të humbura në rrudha të ballit
fatndëshkuar e djegur mallit
ngjyra të zbehura faqes barit
hiri fjetur në vatër zjarrit
thinja bore mbi kokë tharë
ka shumë kohë që s'ju kam parë

shokë e miq të vërtetë
rrugëve të vuajtjes kemi tretë
rrugë triumfi
rrugë kujtimesh
rrugë humbjesh e zhgënjimesh
rrugë fitoresh
rrugë gëzimi
rrugë harrimi pa hak
mes dëlirësisë e pafytyrësisë
kafshatë e ligësisë
ngeli n' lak
shokë

Në heshtje

njëjtë
si pararëndësit e tij
iku në heshtje që këtej
u qërua nga kjo botë
përbuzësi
prej kohësh çakorduar
joshur nga besëtytnitë
mes hijeve fortifikuar
buzëqeshje e vrarë
mbështjellë me petkat e vetmisë
pjellë e djallit
nga dritare e kështjellës së verdhë
iku atje tej
duke vjellë vrer

E hidhur

larushë të radhës së gjatë
prapa hënës dhe pas diellit
të yshtur
pas yjeve të qiellit
o bijtë e lakmisë
çakërritur
me gishtërinjtë e thatë
tapitë e humbjes së dekadave
po mbanin si dhuratë

sa e hidhur
më kot pritëm ne
mbetën po ata
miq të zhgënjimit përgjithnjë
kohë që nuk riparohet dot
kohë që na kushtoi
edhe sot
kohë e të çakërriturve
që atdheu po i mban rëndë në qafë
shija e hidhur mbrapa nesh
do mbesë
do mbesë bukur gjatë

Ngatërrim

mbase
me dashje ngatërruan rolet
erdhën rishtarët diletantë
komeditë i bënë paçavure
rolet ndërruan prijatarët
për ta lozur rolin e të dështuarit
në kuvendin e urtësisë
nuk u dashtë aq mund
mundin shpagoi spektatori
mbase me dashje
ngatërroi urtarin me horrin
ngatërrim

Të dehur

“heronjtë” e ditëve tona
esëll nuk i takuam dot
nga tavernë e kafenesë së qytetit
surbin e kafesë shijojnë
raki e mish të skuqur
lëmë e shtruar
koqen e qejfit po bëjnë
nam të zi po lënë

të dehurit e ditëve tona
për atdhe
nga “mallëngjimi”
dehur e përmallë
kur në tryezën e pistë
janë shtruar së bashku
të shitur
faqezi e tradhtarë
dehur e bërë përrallë
ata
namin e zi po lënë

Pa të keqe

elegant e aristokrat hiqej
davanë nuk ia kishte
rolet e huaja imitonte
sa keq
nuk po e kuptonte
fiksionin kishte ngatërruar
me dëshirën për të bërë rrëmujë
brenda sojit të vet
po shitej i huaj

këta sqimatarë e poterexhi
i bëjnë të qeshin të tjerët
dhe mua
të qaj
me lot në sy

Shpërfillës

rrudhat në faqet e shoqërisë
më shqetësojnë
më vrasin si hijet e marrëzisë
të kohës së kafshuar
ku të qeshurat bënin bujë
të qeshurat me tanët
të gajasurat me të huaj

deri tek qeshja e fundit
do të harrohet emri yt
ata hiqen modestë
në shpërfillje
as na qeshin
as na qajnë
shpërfillësit
urrejtjen nën rrogoz
e mbajnë

Njerëz

po vuajmë prej hapësirave
përherë e më të pakta
uzurpatorë
kaq shpirtvegjël jeni
a i kujtoni ndonjëherë
njerëzit e parë

ata
që historinë bënë para nesh
jo këta që sot
historinë bënë përrallë
që historinë bënë lesh
do ikin me një barrë halle
prej kësaj bote lozonjare
do ikin prej nesh
do ikin
me marre

Hamendje

duarkryq nuk kishte ndenjur
element plotësues
i strategjisë së shpëtimit moral
për njerëzinë e kombin
nuk ishte hamendur
botërisht kishte diskredituar ligjbërësin
në anën e kundërt të tyre
ishte gjendur
me vetëdije
dje

e sot
po me aq vetëdije
ligjbërësin e dikurshëm
e kishte ngritur në nivel përgjegjësie
hamendje
kujt t'i besojmë
rend dhe ligj- bërësit të cilës lojë

Darkë e sajuar

vuante për të u dukur ndryshe
hiqej këngëtar
e nuk njihte as vokalin e tingullit
me enigmën e tij për të shkëlqyer
nëse do t'i vinte radha
për t'u ulur pranë sofrës
të darkës së sajuar
me lugën e drurit në dorë
kishte ngrirë si statujë
ky peng i kohës sonë
i darkës së sajuar
i darkës së vonë

Stoli

e bukur vezulluese
ç'e do
në gjoksin e huaj
kokën kishte mbështetur
në dremitje po kërkonte
një përqafim tjetër

të hallakaturat e vjeshtës
ëndrrat e kota kishin shpërfytyruar
si flakën e qiririt në fashitje
mbi faqen e murit
gjurmët lënë
shkëlqim në gjoksin e huaj
shkëlqim i rremë
nuk ishte më shumë
së një mashtrim i kotë
në ëndrrat tuaja të pafundme
fatkeqësisht
mashtrim që po zgjatë
edhe sot

KUMBIM KAMBANASH

Stublla

më të nevojshëm se ushqimin
e ndiej
të kuvendoj me njerëzit e gjakut tim
nga largësitë
ku zëri im prej mallit
ngulfatet
një zë mallëngjimi
një zë prej mërgimi

a ishim ne a fati
që besimit na ndau
a fuqi e zezë e motit
armiqësoi profetët tanë
edhe shtëpitë e zotit
i ndau

mallkuar qofshin mohuesit
amen
malli dogji peshën e vet
Stublla e gurtë
Stublla e murtë
atje kur Krishti zbriti s' pari
atje
ku e priti shqiptari

Efekt emocional

ndoshta
efekt emocional ky
shikuar në thellësinë e çështjes
thellë
deri në intimitet
them prapë
ndoshta

të mos shkasim
nga këndvështrimi racional
nuk dukej krejt pa përgjegjësi
ndaj kastës së të ligjve
efekt e akt
që pasqyron ndjenjat
mos humbni arsyen
e veprimit
për efektin emocional

Burrë të jesh

në kurriz të tjerëve
luajnë rolin e vet hileqarët
sipas nevojës
rolet përshtatin prapa kuluareve
“baballarët e kombit”
që piketojnë kotësinë
pa cak e pikësynim
ata
kalërojnë atllarët

në këtë udhëtim tani
të vetëdijshëm se një jetë e re
po fillon
ndodhur përballë të papriturave
hileqarë
nuk e kisha marrë vesh
nuk e kisha marrë me mend
kaq ulët paskeni ra
nuk qenka e lehtë burrë të jesh
fryma në dysh m’u nda
burrat sot
ku t’i gjesh

Botë moderne

kambanat po bien me rrapëllima
ruana zot
po t'i kisha unë në dorë
do ta zgjoja botën e fjetur
degdisur në shtratin e saj të heshtur
me rrapëllima
do zgjuar kjo botë profane
zhytur në pellgun e errësirës
së kësaj nate të madhe

ju inferior e shpirt vrarë
frytin e braktisur kujtoni
nga afër dritares dëgjoni
çjerrjet e natës
tundimin e saj
nga kumbimi i kambanave
klithje
thirrje
vaje
për fatin e lig të atyre
për fatin e lig të saj
botë e kambanave në klithje
me dridhma e përpëlitje
shënon rënie
apo ngritje

Tkurrje

reliev i atdheut tim
si hartë e zhubrosur mbledhur shuk
futur në grushtin e hekurt
kohë e re
bartëse e pazarit të kohës së vjetër
kur hartat na i shthurnin
dhe gurët
tek derë e shtëpisë
na i ngulnin

i ndanin tokat e shqiptarisë
reliev gunga - gunga
të tkurri kaq shumë koha
më shumë
të tkurri dhuna
toka që vazhdon të thërrasë
ku jeni o burra
se frymën ma zu tkurrja

Ngadhënjimtar

në vorbullën e mendimeve të mia
humbur e tretur
papritur ia bëhu ai
tamam burrë
mbeta ulur
këmbët nuk po më bënin
duart po më dridheshin
ngadalë po ligështohesha
a veten po merrja
ai u kthye ngadhënjimtar
i madh sa një mal
erdhi për të ngrënë
bukën e lirisë
biri ynë
biri i shqiptarisë

Mos më kërkoni

fjalët e duhura
të lodhshmit e kësaj bote
me qiririn në dorë kërkojnë
në mesin e kësaj errësire
mbase për shpagim shpirtëror
lutjet e motit që shkuan huq
shpërfillësi si gjithnjë
as nuk u skuq

në adresën e gabuar
keni dërguar mesazhin e mëshirimit
shpërfillësit e djeshëm
mos i falini
as këtë mot
se mëshirimi iu shkon kot

ai më së paku kërkoj nga ne
të vetmen fjalë që tha
luteni
mos më tjetërsoni
së tjetërsimi më fyen
të paktën
atje ku nuk jam
mos më kërkoni
mos

Ecje

me vështrimin e tretur larg
meditim në ecje
në rrugën e madhe të kësaj bote
me hapin tim të vendosur
shkeli me kujdes
mbi buzët e çara të tokës së plasaritur
dhembjet nuk dua t'ia rëndoj
ecje përpara
në plasaritjet e tokës së etur
për një pikë uji
atje thellë
ku ka zënë fill fara

me gjithë krenarinë e ecjeve
në rrugët vjeshtake
nën prizmin e syzeve të mbylltë
më i moshuar se dje
më i ri se sot
një jetë na vëzhguan ata
ata që vranë kohën kot

vrulli ynë djaloshar
me zemrën e madhe
ngjyrën e frikës ka vrarë
sakrificë që nuk shpaguhet kurrë
ecje që vrau hijet
me rrezet e diellit të parë

ecje me ballin lartë
ecje krenare pa ndrojtje
mbi buzët e tokës së plasaritur
një copë qiell
një grusht diell
një pikë uji
një copë liri
ku do rrojmë së bashku
të gjithë
edhe
unë e ti

E dukshme

a ia vlen
të dëgjosh leksione
nga ata që leksionet
nuk i pranojnë
mbi të vërtetën që nuk e mbrojnë
e dukshme
mungesë guximi
për ta dëgjuar
për ta thënë
për ta mbrojtur
të vërtetën
ata duna një leksion të mirë
vërtetë
sa ia vlen tani kur e gjitha ajo që iku
nuk rikthehet dot

Nga lart

nga lart më sheh
si cubat më ke zënë pritë
besëprerë
zemra ime e lodhur
ritmin e dikurshëm nuk e mban më
dilemës së përzgjedhur
po i vjen fundi i fundit
çfarë të të them

vetëm dielli është i pamposhtur
e hidhur por e vërtetë
dy fjalë për ne
dy fjalë për atë
dy fjalë për botën
në beteja me lakmitë
të pakët fituan
më se paku ata
që gjërat i shihnin nga lartësitë

Thuaj

gjuhë e heshtur
pret me durim
ata që shfryen deri në banalitet
herezi që na shpuri në lajthitje
cilat ishin fijet e padukshme të durimit
nga ku ishte kapur ai
për të mos rënë në krahët e dëshpërimit
për të mos rënë
më poshtë se hija e vet

ndero të ndershmit
gjërat thirri në emër të vet
hajnit thuaj me emër
hajn
gënjeshtarit
gënjeshtar
sajuesit imoral
tradhtarit
tradhtar
shpirtërisht ndihu i lehtësuar më pastaj
ke thënë të vërtetën e natyrshme
gjërave ju ke thënë
në emër të vet

Moshë dhe vite

ngarkuar mbi kurrizin tonë
vitet
për ditë po rritën
po shtohen
në kujtesën tonë mbetën
bëmat që ikën
bëmat që kalëruam
vite që nuk mund të peshohen

sa ishim gjallë e të fortë
nuk e vlerësuam kohën
kohën që na iku ndër duar
o zot sa jemi penduar
iku e nuk kthehet më
përballje e plasur në sfondin e verdhë
tek liria e shumëkërkuar
lini hapur
e mos e mbyllni atë derë

kush di të qetësojë shpirtrat e trazuar
shpërndarë në qindra pjesë
mbi copat e prera të jetës
moshë dhe vite
si në ëndërr
kohë në ikje

Të kërkoj

duart më ranë copë duke gërmuar
në mos
në gjirin e tokës do të gjej ty
e ti
mbi dhe qenke
hyjni
kush s'të këndoj ty

në udhëkryqet e ngatërruara të jetës
mos humbni shpresat
gjërat mos i merrni me rrëmbim
gjyko arsyeshëm mbi synimet tuaja
narracion në ikonizim
hyjni e kultit tragjikomike
duart me ranë copë
kërkoj shpërfytyrimin tënd
me ecje e në vrap
të kërkoj e nuk të gjej
me ngulm
do të kërkoj prapë

Më duhesh

miku im i dashur
me duhesh
mbase më shumë së kurrë
fjalën patëm dhënë
ta gjejmë veten
së bashku me të vërtetën që është një
në orën e vdekjes
mos të shkelim të ndruajtur
peshën e gjykimit ta ndjejmë
si peshën e gurit
në shtegun e prurjeve të vonuara
ta mbajmë fjalën e burrit
do vdesim vertikalisht e në këmbë
sa ishim gjallë e të fortë
me gojën tonë patëm thënë
do vdesim
po
do vdesim në këmbë

Peizazhe

përtej mureve të gurta
peizazhe të vona
në perëndim të diellit
nuanca të papërsëritshme përjetimesh
fryma jote
gjithkund e pranishme
si tufë zogjsh në fluturim

përtej mureve të gurta
që vrasin kuptimin e jetës
me gjuhën memece të heshtjes
frymë e këputur

përtej largpamësisë sonë
atje ku valon palë e flamurit
në tentim për të triumfuar
mbi kohët e vrazhda të gurit
ku peshë e gurit flet
me gjuhën e popullit
“guri rëndë peshon në vend të vet!”

Mes

mes dy botëve në mëdyshje
atje ku njëra mbaron misionin e saj
fillon tjetra
vazhdimësi sfiduese
si hallka zinxhirësh
futur në kthetrat e kohës së re
nëse do kemi mundësi
edhe atje
të shkruajmë kështu
nga një këngë të bukur
nga një poezi
që pavdekësinë pret
muza që na joshi
me fuqinë e vet

Të gjithë

në këtë jetë
të gjithë jemi sprovuar nga pak
djegur jemi
gëzuar
fyer e prekur
zhgënjyer e ngazëllyer
si valët e lumit në përplasje
me buzë në vaji
e zemër në plasje

në kacafytje me brengat e saj
për të ecur vertikalisht
jemi përpjekur
të mos na tregojnë me gisht
të tjerët
me sprovat e saj jemi ndeshur
pa plagët e shpirtit
kush ka shpëtuar
krenarë qëndroni për ballë saj
jeta është e mirë
jetoni atë
jetën
askush nuk ta falë

Zvicër, 2012

Shënime për autorin

Mehmet Bislimi lindi më 24 mars 1958 në fshatin Prekaz i Epërm të Skenderajt. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, kurse gjimnazin në Skenderaj. Në Universitetin e Prishtinës studioi shkencat natyrore. Në vitin 1981, për shkak të veprimtarisë atdhetare, arrestohet dhe dënohet me burg. Pas daljes nga burgu, më 1986, veprimtarinë kombëtare e vazhdoi në gjirin e LPK-së, ku pati detyra me përgjegjësi. Në vitin 1994, i përndjekur nga regjimi serb u strehua në Zvicër, ku vepron dhe jeton me familjen e tij. Gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka bartur detyra me përgjegjësi.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që herët. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën"Bota e re", Prishtinë, 1986. Më vonë në revistën" Alternativa", në Lubjanë, si dhe në disa numra të gazetës "Rilindja", që botohej atë kohë në Zvicër.

Disa vjet ka shkruar për organin e LPK-së "Zëri i Kosovës" që botohej në Zvicër dhe për të përkohshmen "Rruga jonë"- që dilte në Francë. Në të dy gazetat, për një kohë të gjatë, është paraqitur edhe me këndin e humorit me nofkat "Ngucakeqi" dhe "Gjembi". Kohë pas kohe shkrimet e tij kanë gjetur vend edhe në gazetën "Epoka e re", "Lajm", "Kosova sot", "Shekulli"

etj., si dhe shkrime të shumta në dhjetëra faqe elektronike. Veprimtaria e tij letrare përfshin shkrime publicistike, anekdota, humor, poezi, prozë, si dhe mendime të urta popullore. Deri më tani ka botuar këta libra:

1. ”Anekdota popullore dhe satira autoriale I”, Prishtinë 2002
2. ”Trëndafila maji” – poezi, Prishtinë 2002
3. ”Fjalë dhe gurë” – poezi, Prishtinë 2003
4. "Këtu i thonë Drenicë - Tahir Meha – monografi“, Prishtinë 2004
5. "Ironi e verdhë" - poezi, Prishtinë 2005
6. "Stinë e vonuar" - poezi, Prishtinë 2008
7. "Shkrime publicistike", Prishtinë 2009
8. "Anekdota popullore dhe satira autoriale II" - Prishtinë 2010
9. “Mehmet Delia - alias Mehmeti i Vogël”- monografi, Prishtinë 2011
10. “Shpirtndrituri”- poezi, Prishtinë 2012, është libri i tij i radhës.

Përmbajtja

FJALA E REDAKTORIT..... 7

DREJT SHTEGTIMEVE TË REJA E MË TË THELLA POETIKE..... 7

MADHESHTI E YJEVE..... 17

LEGJENDARIT..... 18
REMZI ADEMIT..... 20
LUANIT..... 21
VATËR KRENARE..... 22
GËNJEVA..... 23
GJITHMONË..... 24
PIKA LOTI..... 25
ÇAMËRI..... 26
NËNTORI..... 27
NDËR SHEKUJ..... 28
ME GJUHËN E VET..... 29
SI NË ËNDËRR..... 30
SA MALI..... 32
E TILLË ISHTE JETA..... 33
HYRJE NË PRANVERË..... 35
VLORA..... 36
RREZE DIELLI..... 37
KËNGA IME..... 38
NUMRA..... 39

URTARË MJEKËRBARDHË..... 41

MESAZH..... 42
AI..... 43
MURE..... 44
SYRI I KEQ..... 45
MES MIQSH..... 46

DASHURI 47
ASKUSH SI AI 48
NJË SHENJË 49
KY VEND 50
PRANË SOFRËS 51
E NDIEJ 52
E GJETA 53
PËRZIERJE 54
ÇUDITËRISHT 55
BUJARI NJERËZORE 56
BOTË E PËRTEJME 58

ZANORET E BARDHA 59

KTHEHU 60
ABUZIM 61
DRITËRO AGOLLIT 62
SHTEGTIM 63
TOKA JONË 64
LAJTHITJE 65
SPROVË 66
E THA 68
NUK ERDHA 69
E VËRTETA 70
GJENERATË 71
ZËRIN NGRITA 72
MENDJEMADHËSIA 73
TË GJALLË 74
ZOTIN DËSHMITAR 75
KËRKOJË FALJE 76

MALLI I PËRFLAKUR 77

TROKITJET 78
SI TRËNDAFILI 79
ENIGMË 80
TË URTËS NËNË 81
FËMIJËRISË 82

NË KRAHËT E KËNGËS 83
KËNGË 85
SYKALTËR 86
ÇASTE 87
PRITJE 88
PËR DITË 89
MALLI 90
PORTA IME E LASHTË 91
GURI 92

LIRIKAT E FJETURA 93

ORË E VONË 94
NUK DUA 96
NJË DITË 97
LOZONJARE 98
LULE BARDHA 99
DËSHIRË 100
SI HËNA 101
KËNGË SKOFIARE 102
SORKADHES 103

TINGULL I GËRVISHTUR 105

SHOKË 106
NË HESHTJE 107
E HIDHUR 108
NGATËRRIM 109
TË DEHUR 110
PA TË KEQE 111
SHPËRFILLËS 112
NJERËZ 113
HAMENDJE 114
DARKË E SAJUAR 115
STOLI 116

KUMBIM KAMBANASH 117

STUBLLA 118

EFEKT EMOCIONAL 119
BURRË TË JESH 120
BOTË MODERNE 121
TKURRJE 122
NGADHËNJIMTAR 123
MOS MË KËRKONI 124
ECJE 125
E DUKSHME 127
NGA LART 128
THUAJ 129
MOSHË DHE VITE 130
TË KËRKOJ 131
MË DUHESH 132
PEIZAZHE 133
MES 134
TË GJITHË 135

SHËNIME PËR AUTORIN 136

PËRMBAJTJA 138

ISBN

Tirazhi
200 copë

Formati
120 X 190

Shtypur në shtypshkronjën
Shkrola
Prishtinë
2012